



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 tetor 2021
Nr. ref.:RK 1885/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI92/21

Parashtrues

Fadil Ponosheci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të
Privatizimit, AC-I-19-0146-A001, i 14 janarit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fadil Ponosheci (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit AC-I-19-0146-A001 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 14 janarit 2021, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit, i cili pretendohet t'i ketë shkelur parashtruesit të kërkesës të drejtat e garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetua), në ndërlidhje me nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 maj 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën, nëpërmjet postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 14 maj 2021.
6. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
7. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 20 maj 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës KI92/21, dhe nga i njëjti kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës dhe bashkëngjitjen Aktvendimit C-IV-14-1167 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), si dhe

dokumenteve tjera mbështetëse. Të njëjtën ditë, në pajtim me ligjin, u njoftua edhe DHPGJS-ja.

9. Më 9 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës të plotësuar, të cilit nuk ia kishte bashkëngjitur Aktvendimin C-IV-14-1167 të DHPGJS-së.
10. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 21 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me kërkesën për kompensim dëmi në shumën prej 18.143,19 euro, të ngritur kundër AKP-së, si administratore e ndërmarrjes shoqërore N. Sh. Agimi-Gjakovë, e cila iu ishte nënshtruar procesit të likuidimit nga AKP-ja.
13. Më 12 shkurt 2014, Autoritetit i Likuidimit nëpërmjet Vendimit PEJ095-0001, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e dëmit material në vlerë monetare, prej 18.143,19 euro.
14. Më 27 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në DHPGJS, ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të 12 shkurtit 2014, duke kërkuar anulimin e vendimit në fjalë dhe aprovimin e kërkesës për kompensim dëmi në lartësinë e lartcekur.
15. Më 24 prill 2019, DHPGJS nga parashtruesi i kërkesës kërkoi të paguante taksën gjyqësore, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga pranimi i vërejtjes, në të kundërtën ankesa e tij do të konsiderohej e tërhequr.
16. Më 4 dhe 22 maj 2019, DHPGJS tentoi sërish t'ia dërgonte parashtruesit të kërkesës vërejtjen gjyqësore për pagesën e taksës, megjithatë shërbimi postar kishte konstatuar se shtëpia ku ishte dhënë adresa ishte shitur dhe se parashtruesi kishte ndërruar vendbanim.
17. Më 31 maj deri më 7 qershor 2019, DHPGJS, sipas ligjit kishte afishuar vërejtjen gjyqësore në tabelën e shpalljeve dhe me këtë rast DHPGJS konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk ka shprehur interes për çështjen e tij, andaj ankesa e tij konsiderohet e tërhequr.
18. Më 15 korrik 2019, shkalla e parë e DHPGJS-së nxori Aktvendimin C-IV-14-1187, nëpërmjet të cilit, ankesa e parashtruesit të kërkesës u konsiderua e tërhequr, me arsyetimin se taksa gjyqësore nuk ishte paguar brenda afatit të kërkuar, edhe përkundër tërheqjes së vërejtjes për ta bërë një gjë të tillë.

19. Më 21 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit, ndaj Aktvendimit të 15 korrikut 2019, të shkallës së parë të DHPGJS – së, me pretendimin se i është shkelur e drejta për qasje në drejtësi, e garantuar me KEDNJ, ngase vërejtjen gjyqësore për pagesën e taksës nuk e kishte pranuar as ai dhe as familjarët e tij. Sipas shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi e ka pranuar faktin se kishte ndërruar vendbanim.
20. Më 23 nëntor 2020, DHPGJS ankesën e parashtruesit të kërkesës ia kishte dërguar AKP-së, si palë e interesuar, për të parashtruar përgjigjen e saj, e cila nëpërmjet përgjigjes së ushtruar, ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës, kërkoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe Aktvendimi i shkallës së parë i DHPGJS-së i 15 korrikut 2019, të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
21. Më 14 janar 2021, Kolegji i Apelit nxori Aktvendimin AC-I-19-0146-A001, nëpërmjet të cilit e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, ushtruar ndaj Aktvendimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, të 15 korrikut 2019, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar se kishte ndërruar vendbanimin, megjithatë ai nuk e kishte njoftuar gjykatën për një gjë të tillë, andaj DHPGJS bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ka provuar të vendos komunikim me parashtruesin e kërkesës, por një gjë e tillë ishte e pamundur, për shkak të ndërrimit të vendbanimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit dhe ai i shkallës së parë i DHPGJS-së i 15 korrikut 2019, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se padia e tij në mënyrë të padrejtë është konsideruar e tërhequr nga DHPGJS-ja, vetëm për arsye të mospagesës së taksës gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se pranë DHPGJS-së përfaqësohej me përfaqësues të autorizuar dhe në rastin e mosgjetjes së adresës së tij, gjykata ka pasur mundësi që vërejtjen gjyqësore t'ia dërgoj përfaqësuesit të autorizuar të tij, sipas të dhënave në shkresat e lëndës.
24. Parashtruesi i kërkesës, përveç kësaj pretendon se në rastin e tij është zbatuar gabimisht ligji i aplikueshëm, sepse sipas tij çështja e parashkrimit ka qenë e rregulluar me nenin 371 (afati prej 5 vitesh) të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, para 22 marsit 1989, ligj i cili ishte në përputhje me Rregulloren e UNMIKU-t, sepse nuk ishte diskriminues dhe si i tillë do duhej zbatuar. Në këtë kuptim parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 34 i Ligjit për ndryshimin e LMD-së nr. 31/93 i 18 qershorit 1993, i cili ka hyrë në fuqi më 25 qershor 1993, e rregullon ndryshe afatin e parashkrimit, për dallim nga ai i para 22 marsit 1989, që ishte ligj i aplikueshëm në Kosovë.
25. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të evitojë këtë padrejtësi, shkelje arbitrar, duke i anuluar si antikushtetuese vendimet e DHPGJS-së.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 13

(E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 116
[Ndërrimi i adresës]

116.1 Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.

116.2 Në qoftë se kundër vendimit të formës së prerë brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni paraqitet revizioni, afati i tillë zgjatet deri sa të kalojnë gjashtë muaj nga dorëzimi i vendimit i dhënë sipas revizionit, me të cilin revizioni hidhet poshtë, refuzohet apo vendimi i goditur me revizion ndryshohet.

116.3 Në qoftë se kundër vendimit të formës së prerë para se të skadojë afati nga paragrafi 1 i këtij neni, paraqitet propozimi për përsëritjen e procedurës, afati i tillë zgjatet deri sa të kalojë afati gjashtë muaj pas marrjes së formës së prerë të vendimit të dhënë në procedurën e përsëritur, kundër të cilit nuk është paraqitur ankesa, përkatësisht nga skadimi i afatit gjashtë muaj nga dita në të cilën palës i është dorëzuar vendimi i shkallës së dytë.

116.4 Po që se në procedurën sipas mjetit të goditjes së jashtëzakonshme prishet vendimi i formës së prerë dhe çështja kthehet në rigjykim, do të konsiderohet se afati nga paragrafi 1 i këtij neni as që ka filluar të ecë.

116.5 Në qoftë se pala apo përfaqësuesi i saj nuk e njoftojnë menjëherë gjykatën për ndryshimin e adresës, gjykata do të urdhërojë që dërgimet e mëtutjeshme të shkresave të bëhen me anë të afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Kjo mënyrë e komunikimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i saj ta njoftojë gjykatën për adresën e re të saj.

116.6 Komunikimi nga paragrafi 5 i këtij neni konsiderohet i kryer pas kalimit të shtatë ditëve nga dita e afishimit të shkresës në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

116.7 Në qoftë se përfaqësuesi për pranimin e shkresave e ndërron adresën deri në skadimin e afateve nga paragrafët 1-3 të këtij neni, e për një gjë të tillë nuk e njofton gjykatën, atëherë gjykata, me shpenzimet e palës, ia cakton palës përfaqësuesin për pranimin e shkresave nëpërmjet të cilit do t'i dorëzohen shkresat, derisa mos të njoftohet nga pala se ka caktuar përfaqësues të ri me prokurë.

Ligji Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të privatizimit

Neni 35
Nisja e procedurave

- 1. Një padi, kërkesë apo ankesë i dorëzohet me shkrim Dhomës së Posaçme.*
- 2. Një kërkesë apo ankesë përmban:*
 - 2.1. emrin dhe adresën e paditësit (ve).*

- 2.2. emrin dhe adresën e avokatit, nëse ka, që vepron në emër të paditësit;
- 2.3. emrin dhe adresën e të paditurit, deri në atë masë sa përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 25 së këtij ligji;
- 2.4. lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që paditësi synon t'i paraqes;
- 2.5. nëse kërkohet kompensim financiar, paraqitet një listë e dëmeve që përcakton natyrën e humbjes apo dëmit, shumën e parave që pretendohet për çdo lloj humbje apo dëmi, si edhe provat që duhet të paraqiten për mbështetjen të atij lloji të humbjes apo të dëmit, dhe
- 2.6. nëse kërkohet kompensim jo-financiar, paditësi(t) do të saktësojë natyrën e kompensimit të tillë duke marrë parasysh dispozitat e nenit 10 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Paditësi(t) gjithashtu do të paraqet shumën e kompensimit financiar (të mbështetur me një listë të dëmeve që përcaktohet me nënparagrafin 2.5. të këtij neni në rast se Dhoma e Posaçme vendos se nuk mund, ose nuk do të caktojë një kompensim të tillë jo-financiar”.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

28. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin AC-I-19-0146-A001 të Kolegjit e Apelit, të 14 janarit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
30. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh kërkesat e rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht paragrafin (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

31. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në

fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; dhe KI172/21, me parashtrues *Xhevdet Metaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 prillit 2021).

32. Gjykata rikujton se rasti pranë nesh ka të bëjë me një kërkesë për kompensim dëmi, të ngritur kundër AKP-së, si administratore e ndërmarrjes shoqërore N. Sh. Agimi-Gjakovë, e cila i ishte nënshtruar procesit të likuidimit. Kjo kërkesë e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit si e pabazuar, kundër të cilit parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në DHPGJS. DHPGJS paraprakisht kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës të paguante taksën gjyqësore, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga pranimi i vërejtjes, në të kundërtën ankesa e tij do të konsiderohej e tërhequr. Vërejtja gjyqësore për pagesën e taksës ishte tentuar t’i dërgohet parashtruesit të kërkesës edhe 2 herë tjera, por që shërbimi postar kishte konstatuar se shtëpia ku ishte dhënë adresa ishte shitur dhe se parashtruesi kishte ndërruar vendbanim. Nga kjo arsye DHPGJS, kishte afishuar vërejtjen gjyqësore në tabelën e shpalljeve. Pas kalimit të afatit ligjor nga shpallja e vërejtjes gjyqësore DHPGJS përmes Aktvendimit C-IV-14-1167, konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk ka shprehur interes për çështjen e tij, andaj ankesa e tij konsiderohet e tërhequr. Parashtruesi i kërkesës ishte ankuar në Kolegj të Apelit, kundër Aktvendimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, me ç’rast Kolegji i Apelit përsëri përmes Aktvendimit AC-I-19-0146-A001, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi aktvendimin e shkallës së parë të DHPGJS-së.
33. Parashtruesi i kërkesës pranë Gjykatës në esencë ngritë pretendime për shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese për “gjykim të drejtë”, sepse sipas tij (i) nuk është e drejtë të konsiderohet e tërhequr ankesa e tij vetëm për shkak të mospagesës së taksës; (ii) dhe se i njëjti kishte përfaqësues të autorizuar, dhe për këtë arsye aktvendimi është dashur t’i dërgohet atij.

i. Sa i përket pretendimit lidhur me taksën gjyqësore

34. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë pretendim thekson se mospagesa e taksës nuk do të duhej të ishte arsye për ta konsideruar padinë e tij të tërhequr nga DHPGJS-ja dhe Kolegji i Apelit.
35. Në rastin konkret, Gjykata i referohet pjesëve relevante të aktvendimit të kontestuar AC-I-19-0146-A001 të Kolegjit të Apelit, i cili lidhur me çështjen e mospagesës së taksës kishte theksuar dhe arsyetuar, si në vijim:

“Shkalla e parë e kishte konsideruar ankesën si të tërhequr, me arsyetimin se edhe pas tërheqjes së vërejtjes nga gjykata, ankuesi nuk e ka paguar taksën gjyqësore. Vërejtja ishte tentuar t’i dërgohet paditësit më 4 dhe me 22 maj 2019 në adresën e dhënë nga vetë ankuesi, por nga zyrtari postar

është konstatuar se është shitur shtëpia dhe ankuesi ka ndërruar vendbanim. Konform ligjit kjo vërejtje është afishuar në Tabelën e shpalljeve të gjykatës nga data 31 maj deri me 7 qershor 2019 dhe ky komunikim me ankuesin nga ana e gjykatës konsiderohet i ligjshëm. Gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për këtë çështje juridike”.

Ankuesi e pranon se e ka ndërruar adresën, por konsideron se i janë bërë shkelje të të drejtave të tij të përcaktuara nga instrumentet juridike ndërkombëtare, sepse është e qartë se atë vërejtje nuk e ka pranuar as ankuesi e as ndonjë anëtar i familjes së tij. Ankuesi pretendon se me këtë aktvendim atij i është pamundësuar qasja në drejtësi dhe kjo, konsideron ai, është shkelje e të drejtave të njeriut të mbrojtura me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetutën e Kosovës.

Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte vepruar drejt dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe nuk ka bërë asnjë shkelje të dispozitave ligjore apo të procedurës gjyqësore. Në bazë të nenit 35, paragrafi 2.1 i LDHPGJSK-së është i qartë, se një padi duhet të përmbajë edhe adresën e paditësve. Në bazë të nenit 116 paragrafi 1 i LPK-së, pala është e obliguar që ta njoftoj gjykatën nëse e ka ndryshuar adresën. Në bazë të paragrafit 5 të këtij neni, nëse pala procedurale nuk e bënë një njoftim të tillë, atëherë gjykata e bënë afishimin e një shkrese të tillë në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Edhe vetë pala paditëse e ka pranuar se e ka ndërruar adresën por nuk e ka njoftuar gjykatën. Në këtë rast gjykata e ka bërë atë që e ka në dispozicion bazuar në dispozitat ligjore të lart cituara. Gjykata nuk ka mundësi, e as që ka për detyrë që të di nëse një palë e ka ndërruar adresën apo jo, sepse për këtë është obligim i palëve në procedurë që ta njoftojnë gjykatën për një ndryshim të tillë.

36. Nisur nga të lartcekurat, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit kishte theksuar që vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore ishte tentuar t'i dërgohej dy herë parashtruesit të kërkesës. Kolegji i Apelit, duke u bazuar në paragrafin 2.1 të nenit 35 të LDHPGJS-së kishte theksuar që një padi duhet të përmbajë edhe adresën e paditësve, e që në rastin konkret në bazë të nenit 116, paragrafi 1 të LPK-së, pala është e obliguar që ta njoftoj gjykatën nëse e ka ndryshuar adresën. Në bazë të paragrafit 5 të këtij neni, nëse pala procedurale nuk e bënë një njoftim të tillë, atëherë gjykata e bënë afishimin e një shkrese të tillë në tabelën e shpalljeve të gjykatës.
37. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përgjatë procedurës së zhvilluar në DHPGJS e kishte pranuar vetë se kishte ndërruar vendbanimin, gjegjësisht adresën, megjithatë për një gjë të tillë i njëjti nuk e kishte informuar DHPGJS-në. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se mospagesa e taksës nuk duhej të ishte arsye për t'iu konsideruar e tërhequr padia dhe ankesa e tij.
38. Gjykata vë në dukje se çështja e pagesës/mospagesës së taksës gjyqësore është ngritur në Gjykatën Kushtetuese edhe në disa raste të tjera, përkatësisht në rastin KI62/18, parashtruese *Nadlije Gojani*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 27 shtatorit 2018, dhe rastin KI78/18, parashtrues *Pashk Malota*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 27 shkurtit 2019 dhe rastin KI57/19, parashtruese *Slavica Miris*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 dhjetorit 2019, dhe

KI60/19, parashtrues *Srđan Stolić*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 1 korrikut 2020). Për ndryshim nga këto raste, Gjykata kishte gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rastin KI80/19, për arsye se parashtruesi i kërkesës në këtë rast kishte kërkuar zgjatje të afatit të pagesës së taksës gjyqësore dhe Kolegji i Apelit, pa e trajtuar këtë kërkesë të parashtruesit e kishte nxjerrë një Aktvendim përmes të cilit e konsideron të tërhequr ankesën (shih rastin e Gjykatës KI80/19, parashtrues *Radomir Dimitrijević*, Aktgjykim i 10 nëntorit 2020, paragrafët 51 dhe 60).

39. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila çështjet e taksave gjyqësore i ka trajtuar në kuadër të së drejtës për “qasje në drejtësi”. GJEDNJ në rastin *Reuters kundër Gjermanisë* theksoi se përderisa neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, siguron që çdokush të ketë të drejtën që kërkesa e tij lidhur me të drejtat dhe detyrimet civile të paraqitet para gjykatave, megjithatë “e drejta në gjykatë” nuk është absolute, por i nënshtrohet kufizimeve të lejuara me implikim, të cilat mund të jenë të natyrës financiare (shih rastin e GJEDNJ-së *Kreuz kundër Polonisë*, Aktgjykim i 19 qershorit 2001, paragrafët 54-60). GJEDNJ, rrjedhimisht thekson se kurrë nuk e ka përjashtuar mundësinë që interesat e administrimit të drejtë të drejtësisë mund të justifikojnë vendosjen e një kufizimi financiar në qasjen e një individi në gjykatë (shih rastin e GJEDNJ-së *Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 13 korrik 1995, paragrafi 61). Si përfundim, në rastin *Reuters kundër Gjermanisë*, GJEDNJ gjeti se kërkesa për t’ia paguar një shumë të caktuar gjykatës, nuk mund të konsiderohet kufizim mbi të drejtën e qasjes në një gjykatë, dhe sa i përket taksave që duhej të paguheshin nga aplikuesi në këtë rast ato nuk i konsideroi si të tepërta (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Reuters kundër Gjermanisë*, Vendim i 5 qershorit 2003, paragrafi 2).
40. Andaj, Gjykata bazuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe të vetë (shih rastet e lartcekura), konsideron se kërkesa për t’ia paguar gjykatës një shumë e caktuar monetare, nuk mund të konsiderohet si kufizim ose mohim i të drejtës për qasje në gjykatë. GJEDNJ kufizimin e kishte gjetur në rastet kur shumat për pagesën e taksës ishin shumë të larta, dhe një gjë e tillë do rezultonte në mohimin e së drejtës për qasje në drejtësi siç garantohet me KEDNJ. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se Ligji për DHPGJS-në, parasheh, ndër të tjera, instrumente ligjore se kur një parashtrues i përmbushë kriteret e përcaktuara, për t’u liruar nga pagesa e taksës gjyqësore, pas pranimi të vërejtjes gjyqësore nga instancat e DHPGJS-së.
41. Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, vëren se nuk ishte e mundur të vërtetohej vullneti i parashtruesit të kërkesës për të paguar ose refuzuar pagesa e taksës gjyqësore, përderisa DHPGJS nuk kishte arritur të vendoste një komunikim të rregullt me parashtruesin e kërkesës, për shkak të ndërrimit të vendbanimit nga ana e tij. Gjykata thekson se në një situatë si kjo kemi të bëjmë me përmbushje të kriterëve ligjore që përbëjnë parakusht për një shqyrtim efikas të parashtrësive, siç është edhe detyrimi për të shënuar me saktësi adresën e vendbanimit, ose në raste të ndërrimit të adresës së vendbanimit detyrimi për të informuar gjykatën në kohë, si mundësi e vendosjes së rregullt të komunikimit gjykatë-parashtrues.

42. Për më tepër, Gjykata, konsideron se konkluzioni i Kolegjit të Apelit, për refuzimin, si të pabazuar, të pretendimit të parashtguesit të kërkesës perkitazi me shkeljen e të drejtës për “qasjen në drejtësi”, e cila garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së është arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm dhe gjithëpërfshirës të ankesës mbi këtë bazë, duke theksuar si përfundim se Aktvendimi i shkallës së parë i DHPGJS-së ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj, për arsyet siç janë përmendur aty.

43. Andaj, nga si më lart, Gjykata këtë pretendim të parashtguesit të kërkesës e konsideron si (ii) pretendim që kategorizohet me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe rrjedhimisht të njëjtin e konsideron qartazi të pabazuar, në baza kushtetuese.

ii. Sa i përket pretendimit lidhur me njoftimin e përfaqësuesit të parashtguesit lidhur me taksën dhe pretendimet tjera

44. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, dhe të vetë Gjykatës, ajo e shpall një kërkesë të papranueshme qartazi të pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me kriterin (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet njëri nga dy kushtet, si në vijim:

a) kur parashtguesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);

b) kur parashtguesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtgues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 43).

45. Gjykata vëren se parashtguesi i kërkesës pretendimin për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, e ndërlidhë me faktin se sipas tij, DHPGJS-së do duhej njoftuar përfaqësuesin e autorizuar të tij lidhur me përmbajtjen e urdhërit për pagesën e taksës. Lidhur me këtë, Gjykata së pari vëren se në Aktvendimin AC-I-14-0002, nuk potencohet se parashtguesi i kërkesës ka pasur përfaqësues të autorizuar, ndërsa sa i përket Aktvendimit C-IV-14-1167 të shkallës së parë të DHPGJS-së, parashtguesi i kërkesës nuk ia ka bashkëngjitur të njëjtën kërkesë si provë materiale, ashtu siç i ishte kërkuar nga Gjykata me shkresën e 21 majit 2021, nga ku mund të konfirmohej nëse në shkresat e lëndës kishte shënuar adresën e tij apo të përfaqësuesit si adresë komunikuese me gjykatën. Andaj, barra e përgjegjësisë i takon parashtguesit të

kërkesës nëse ai dështon të mbështes me prova materiale pretendimin e tij për shkelje të të drejtave kushtetuese.

46. Andaj, nga arsyet e cekura, Gjykata, konstaton se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës, i takon kategorisë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, prandaj, rrjedhimisht i njëjti deklarohet qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.
47. Në fund, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës vetëm citon nenin 32 të Kushtetutës mirëpo i njëjti, nuk shpjegon specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve të Kushtetutës. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIO4/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38- 39).
48. Rrjedhimisht, Gjykata edhe këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës e cilëson si pretendim që i takon kategorisë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj i njëjti është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.
49. Prandaj dhe përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113. 7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 21 tetor 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani